



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
SEKTORI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, LETRAVE DHE PLATFORMËS
SË BASHKËQEVERISJES

Nr.2879//1 prot.

Tiranë, më 27.03.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. P. T.

Adresa: Lagjja nr. 8 ,

Korçë

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me nr. 2879 prot., datë 10.03.2025, ju informojmë se:

Në nenin 31, të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar se: *“Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të po këtij ligji”.*

Në zbatim të nenit 92, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me Ligjin nr. 104, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7703/11.5.1993”, nga data 01.01.2015 vjetërsia e plotë e kërkuar për pension pleqërie si për burrat edhe për gratë shtohet në mënyrë graduale me nga 4 muaj çdo vit deri në vitin 2032.

Ndërsa në nenin 92, pika 4, të Ligjit nr. 7703/11.05.1993, të ndryshuar, është përcaktuar se: *“Periudha e kryerjes së studimeve në shkollën e lartë, me shkëputje nga puna për gruan, duke filluar nga data 01.09.2000 dhe deri më 31.12.2032, pavarësisht nga vendi se ku janë kryer studimet dhe për jo më shumë se 6 vjet, njihet periudhë sigurimi vetëm për efekt pensioni pleqërie. Në kuptim të këtij neni, viti shkollor është me 12 muaj. Në këtë rast, kontributet përballohen nga Buxheti i Shtetit, në kohën kur merret vendim përcaktimin e pensionit”.*

Ju jeni e vitlindjes 1963 dhe sipas nenit 92, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e drejta për të përfutur pension pleqërie, ju lind në datën 01.07.2025, në moshën 61 vjeç e 10 muaj dhe me vjetërsi të plotë 38 vite e 8 muaj.

Gjithashtu, ju sqarojmë se në nenin 33, të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993", është përcaktuar se: *“I siguruari, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie sipas nenit 92, të këtij ligji, merr shtesë në masën 0,5 për qind të pensionit për çdo muaj që shtyn datën e daljes në pension dhe vazhdon të paguajë kontribut", mbi vjetërsinë e plotë të kërkuar”.*

Ndërsa në lidhje me shtyrjen e marrëdhënieve të punës mbi moshën e pensionit, ju bëjmë me dije se, në pikën 4, të VKM nr. 478, datë 16.06.2010, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie”, përcaktohet se: *“Organet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, me plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas dispozitave të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ndërpresin menjëherë marrëdhëniet e punës për këtë kategori nëpunësish/punonjësish”*.

Sa më sipër, në rast se jeni i punësuar në administratën shtetërore dhe nuk plotësoni vjetërsinë e plotë të kërkuar në nenin 92, të Ligjit nr. 7703/11.05.1993, të ndryshuar, për përfitim pensioni pleqërie, shtyrja e marrëdhënieve të punës mbi moshën e pensionit është kompetencë e institucionit ku punoni dhe jo e sigurimeve shoqërore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.